



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

3365
Nr. ____ prot.

Roskovec, më 24.06.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 34, datë 24.06.2025

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77,
DATË 23.12.2024 “PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË PBA
2025-2027 DHE BUXHETIT TË VITIT 2025”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54 shkronja “dh” të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 77, datë 23.12.2024 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025”, të ndryshuar si dhe shkresës Nr. 4065, datë 22.05.2025 të Sektorit të Qendrës Social-Komunitare në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Kulturore Bashkia Roskovec dhe shkresës të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr. 676, datë 19.06.2025, protokolluar në Bashkinë Roskovec me Nr. 5212, datë 20.06.2025,

JU PARAQESIM PËR DISKUTIM E MIRATIM:

1. Ndryshimin e pikës 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 77, datë 23.12.2024 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025”, të ndryshuar, si më poshtë vijon:
 - Numri maksimal i punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive administrative e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2025 nga **397 (treqind e nëntëdhjetë e shtatë)** punonjës të përhershëm bëhet **402 (katërqind e dy)** punonjës të përhershëm. Konkretisht:
 - shtohen në organikën e njësisë shpenzuese “Bashkia Roskovec” **4 (katër)** punonjës të përhershëm dhe numri maksimal i punonjësve për njësinë shpenzuese “Bashkia Roskovec” ndryshon nga **186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë)** bëhet **190 (njëqind e nëntëdhjetë)** punonjës të përhershëm, si dhe
 - shtohen në organikën e njësisë shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” **1 (një)** punonjës i përhershëm dhe numri maksimal i punonjësve për njësinë shpenzuese “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” ndryshon nga **207 (dyqind e shtatë)** bëhet **208 (dyqind e tetë)** punonjës të përhershëm.

2. Fondi të përballohet nga fondi për pagat dhe sigurimet shoqërore të miratuar për vitin 2025.
3. Pas miratimit të këtij projekt-vendimi ngarkohet për zbatim Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit, si dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Konceptoi: *S.Çepele*

V.Zeqo

Konfirmoi: *D.Hoxha*

KRYETARI

Majlinda Bufi

